



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 17 paragrafi 17.1 Ligji nr. 2003/10 për plehra artificiale, dt. 23 Qershor 2003, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.04/2009

Për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet taksa për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale.

Neni 2

1. Të gjitha llojet e plehrave artificiale që importohen, dhe tregtohen në Republikën e Kosovës, duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve.
2. Subjektet që merren me importimin, tregtimin e plehrave artificiale, duhet të licencohen në Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Neni 3
Aplikimi

1. Për t'u licencuar si importues dhe tregtues i plehrave artificiale, subjekti duhet të aplikoi në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve.
2. Pas shqyrtimit të aplikacionit për licencim, lëshohet licenca aplikuesit vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin Nr. 2003/10 për plehra artificiale dhe me këtë udhëzim administrativ.

Neni 4

1. Kërkesës për licencë për importim të plehrave artificiale, duhet t'i bashkëngjitet ky dokumentacion:
 - 1.1 Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit;
 - 1.2 Informatën e biznesit;
 - 1.3 Diploma e Shkollës mesme bujqësore ose Diplomën e Fakultetit të Bujqësisë;
 - 1.4 Objekti i pranuar për veprimtari afariste nga KK;

- 1.5 Autorizimin nga Kompania prodhuese për llojet e importimit të plehrave artificiale që i tregton;
- 1.6 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos.
2. Kërkesë për vazhdim të licencës për importim dhe tregtim të plehrave artificiale, duhet ti bashkëngjitet ky dokumentacion:
 - 1.1 Licenca paraprake e lëshuar nga MBPZHR;
 - 1.2 Autorizimin nga Kompania prodhuese për llojet e importimit të plehrave artificiale që i tregton;
 - 1.3 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos.

Neni 5

1. Kërkesës për licencë për tregtim të plehrave artificiale, duhet bashkëngjitur këtë dokumentacion:
 - 1.1 Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit;
 - 1.2 Informata e biznesit;
 - 1.3 Diploma e Fakultetit të Bujqësisë;
 - 1.4 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos.

Neni 6

1. Subjektet të cilët paraqesin kërkesë për vazhdimin e licencës për import dhe tregtim të plehrave artificiale, duhet që në afatin kohor 30 ditësh para skadimit të afatit të paraqesin kërkesë për vazhdim.
2. Kohëzgjatja e licencës për subjektet që importojnë dhe tregtojnë plehra artificiale, lëshohet për periudhën kohore tri vjeçare.
3. Në rastet kur subjektet bëjnë shkelje dhe nuk e zbatojnë Ligjin Nr. 2003/10 për plehra artificiale dhe këtë udhëzim administrativ, i pezullohet licenca nga organi kompetent.

Neni 7

Taksa

1. Shuma e taksës për licencim të subjekteve të cilët importojnë plehra artificiale është 100€ndërsa për vazhdim të licencës 90€
2. Shuma e taksës për licencim të subjekteve të cilët tregtojnë plehra artificiale është 80€ndërsa për vazhdim 60€

Neni 8

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 15 Ligji Nr. 2003/10 për plehrat artificiale.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 27.02.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
